



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 3/8 Prot

Vlorë, më 17 . 02 . 2023.

VENDIM

Nr. 2 , datë 09.02.2023

PËR

MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR” ME QËLLIM SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE INERTE QË NXIRREN NGA SHTRETËRIT E LUMENJVE, PËRRENJVE, LIQENEVE, ME OSE PA UJË, ME VENDNDODHJE: SHTRATI I LUMIT BËNÇË, BASHKIA TEPELENË, QARKU GJIROKASTËR

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, “Për përdorim burimi ujor”, me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë me vendndodhje: Shtrati i Lumit Bënçë, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastër, për zbatimin e projektit “Rehabilitim i segmentit rrugor Fier-Vlorë (rruga e vjetër)”.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri burimit ujor: Lumi Bënçës

Koordinatat e vendndodhjes së burimeve (KRGJSH)

X	Y	Z
501096	4463122	136.2 m.m.n.d
501040	4463033	137.0 m.m.n.d
501048	4462928	137.8 m.m.n.d
500919	4462638	142.3 m.m.n.d
500859	4462668	142.7 m.m.n.d
500900	4462784	139.9 m.m.n.d
500895	4462910	138.4 m.m.n.d
501012	4463148	135.9 m.m.n.d

3. Sipërfaqja e taracës lumore që do të shfrytëzohet : 48 581 m² ;
4. Volumi i materialit të kërkuar : 30 000 m³ ;
5. Subjekti të respektojë të gjitha sygjerimet e dhëna nga AKM-ja dhe SHGJSH-ja;
6. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABU-Vjosë për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;
7. Të ndiqet nga ZABU- Vjosë zbatimi i projektit të rehabilitimit;
8. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;
9. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.



K R Y E T A R

ELAMUR MAMAJ